




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 428/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Goran Milenković -Kryetar, z. Nuhi Pacarizi- Referues z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “NPSH AFA ING”- Suharekë kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Art-Net” Sh.p.k nga Fushë Kosova, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi dhe instalimi i paraturkes për digjitalizimin e QKMF-se, QKF-ve dhe AMF-ve Ri-tender” me nr prok: 613-19-3600-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Kuvendi Komunal Lipjan (KK Lipjan), më datën 14. 08. 2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “NPSH AFA ING”- Suharekë kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe instalimi i paraturkes për digjitalizimin e QKMF-se dhe QKF-ve dhe AMF-ve Ri-tender” me nr prok: 613-19-3600-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- KK Lipjan.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Furnizimi dhe instalimi i paraturkes për digjitalizimin e QKMF-së dhe QKF-ve dhe AMF-ve Ri-tender” me nr prok: 613-19-3600-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- KK Lipjan, dhe lënda kthehet në Rivleresim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “NPSH AFA ING” Suhareke aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 31.05.2019

Data e planifikuar për hapjen e ofertave: 21.06.2019

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm: 04.07.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim: 09.07.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim: 12.07.2019

Me datë 22.07.2019, OE - NPSH “AFA ING” - Suharekë, ka parashtruar ankesë në OSHP kundër vendimit të AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe instalimi i aparaturës për digjitalizimin e QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve-Ritenderim”, me numër të prokurimit 613-19-3600-121, publikuar nga AK – Kuvendi Komunal Lipjan.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 26.07.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe ekspertin teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik në raportin e dt: 01.08.2019, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqarojnë me sa vijon:

Sqarim hyrës - Autoriteti Kontraktues/Kuvendi Komunal Lipjan, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, me vlerë të mesme. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës.

Kundër propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit të OE ankues NPSH “AFA ING”, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK me datë 09.07.2019 me pretendimet e njëjta si në këtë ankesë. Përderisa AK me datë 12.07.2019, ka nxjerr vendim dhe ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Përgjigje në pretendimet ankimore:

1. **Pretendimi ankimor:** Në lidhje me pretendimin se OE të rekomanduar për kontratë i mungon dokumenti për liferim tek kontratat me operator privat si dhe i mungon dëshmia e fletëpagesës për 3 projektet, për kompaninë MAX-i, për IPKO dhe për Baruti Group.

Përgjigje: Në njoftimin për kontratë dhe FTD, AK ka specifikuar kërkesën *Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar furnizime të ngjashme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë minimale prej 50.000.00€.....* dhe dëshminë dokumentare për këtë kërkesë *Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë të dëshmuara me referenca apo procesverbale të pranimit teknik duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e referencës apo certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat....*

OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar katër kontrata, dhe katër referencat apo certifikatat e përdorimit si dëshmi për të përmbushur këtë kërkesë. Megjithatë certifikata e pranimit me subjektin privat IPKO nuk kishte të specifikuar vlerën e kontratës. Një sqarim për këtë çështje AK është dashur ta bëj gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve bazuar në RRUOPP, përkatësisht nenit 39.8.

2. **Pretendimi ankimor:** Mungon lista, e të dhënave (veprimtarive) të biznesit nga ARBK, për operatorin e rekomanduar për kontratë.

Përgjigje: Në njoftimin për kontratë, përkatësisht Përshtatshmëria profesionale, AK ka specifikuar kërkesën *Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit dhe si dëshmi, ka kërkuar Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje).* OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar kopjen e certifikatës së regjistrimit, përderisa të dhënat e veprimtarisë/ve nuk janë kërkuar.

3. **Pretendimi ankimor:** Mungon autorizimi i prodhuesit të zgjidhjes, deklarata e prodhuesi që zgjidhja e ofruar është funksionale dhe deklarata nga prodhuesi që zgjidhja e ofruar është zgjidhje e gatshme (turn-key solution)

4. **Përgjigje:** Në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë janë prezantuar autorizimi i kompanisë PBC për OE të rekomanduar për kontratë. Autorizimi mban datën 19 qershor 2019 dhe është dedikuar për këtë aktivitet të prokurimit. Më tej është prezantuar deklarata e kompanisë PBC përmes të cilës deklarohet se zgjidhja e propozuar është funksionale dhe përmbush të gjitha kërkesat e specifikuar në dosjen e tenderit. Gjithashtu është prezantuar edhe deklarata e kompanisë PBC përmes të cilës deklarohet se zgjidhja e propozuar është zgjidhje e gatshme.

5. **Pretendimi ankimor:** Zgjidhja softwerike e ofruar nga OE, nuk është zgjidhje e mire pasi në ekranin 7 inch, mund të shfaqen vetëm dy shërbime që është vetëm si zgjidhje fiksi, ku AK nuk do të ketë mundësi të shtoj shërbime pre sistemin e pritjes, e me këtë kjo zgjidhje të ofruara nga i rekomanduari për kontratë duhet të shpallet i papërgjegjshëm, pasi që zgjidhja nuk është funksionale dhe e qëndrueshme.

Përgjigje: Zgjidhja softwerike e ofruar nga OE, ka ofruar përmbushjen e kërkesave të përcaktuar në aneksin 1, specifikimet teknike të detyrueshme, në dosjen e tenderit dhe si e tillë përmbush kërkesat e AK, rrjedhimisht ky pretendim është i paqëndrueshëm.

6. **Pretendimi ankimor:** OE i rekomanduar për kontratë, nuk ka asnjë dëshmi që ka implemetu një sistem të menaxhimit të radhës në ndonjë QKMF ose AMF, për dallim që në si kompani kemi implemetu shërbime të tilla, ku edhe janë dorëzuar dëshmitë përkatëse. Zgjedhja softwerike nuk është turn of key solution.

Përgjigje: AK nuk ka specifikuar një kërkesë të tillë në Njoftim për kontratë apo FTD, që OE duhet të ofroj dëshmi që ka implemetuar një sistem të menaxhimit të radhës në ndonjë QKMF ose AMF, andaj pretendimi është i paqëndrueshëm.

7. **Pretendimi ankimor:** OE i rekomanduar për kontratë nuk i përmbushin specifikat teknike e ofruara për kamerën modeli DH-HAC-HVF1230TLA, nuk i përmbushin kërkesat specifike minimale teknike, siç janë kërkuar nga AK në dosje të tenderit, pasi lensi i ofruar për kamere është ofruar me i vogël se sa ai i kërkuar në specifikacion (kërkohet 8mm ndërsa me këtë model është 6mm). Po ashtu modeli i ofruar, nuk i përkrah fps (Kamera 2 MP Bullet) siç është kërkuar në FTD (50/60fps) .

Përgjigje: Në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 për Specifikimet e detyrueshme teknike nuk ka specifikacione teknike për pajisjet harduerike. Megjithatë në formularin për çmime në

formatin Excel AK ka specifikuar kërkesat teknike. Në këtë specifikim për pozicionin 1, është kërkuar ICR, OSD, 3.6mm fixed lens (6mm, 8mm optional). Në katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë specifikimi për është 3.6mm fixed lens (2.8mm, 6mm optional).

8. **Pretendimi ankimor:** Kabulli i ofruar UTP (CAT 6A U-UTP installation cable), nuk e përkrah 500 MHz, maksimale ajo e ofruar mbështet deri në 250 MHz, e jo 500 MHz siç është kërkuar, pra nuk i plotëson kërkesat minimale teknike që janë kërkuar nga AK.

Përgjigje: Në katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, për kabullin UTP është ofruar katalogu ku specifikohet produkti me Part Number: 7965E. Në të dhënat për këtë produkt specifikohet se ky produkt është i kategorisë 6 dhe përkrah (250MHz), e jo sikurse është specifikuar në formularin e çmimit për këtë pozicion ku është 500 Mhz.

9. **Pretendimi ankimor:** Nuk plotësohen kërkesat e ofruar nga OE, me ato të kërkuara nga AK tek pozicioni për "Rack Kabinet", nuk është specifikuar modeli i saktë i Rack Kabinet, ku OE ka ofruar variante të Rack Kabinet 7U (500x680x530), 9U (590x680x530), 12U (720x680x530 mm) dhe 16U (900x680x680 mm), që është në kundërshtim me FTD, pra nuk janë kërkuar variante, por zgjidhje konkrete.

Përgjigje: Në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 për Specifikimet e detyrueshme teknike nuk ka specifikacione teknike për pajisjet harduerike. Katalogu i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë ofron mundësi/variantë të ndryshme, ndër to edhe modelin 7U me dimensione 600x450 mm.

10. **Pretendimi ankimor:** Mungojnë të dhëna (përshkrim) për: Inverter, Kompjuter, BNC Connector, DC jack për furnizim me rrymë, plastic channel, kabullit RG-59, kabllit, trafo-s.

Përgjigje: AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, AK nuk ka kërkuar katalog apo përshkrim të produkteve të ofruar për tenderuesit, rrjedhimisht mungesa e përshkrimit të produkteve në tender, nuk mund të shërbejë si kriter për eliminimin e OE gjatë ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve.

Bazuar në sqarimet e mësipërme, pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara.

Mendimi i ekspertit shqyrtues/teknik

Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti shqyrtues / teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues - NPSH "AFA ING", të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe rekomandon që të anulohet vendimi i AK-së dhe aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës 02 gusht 2019 ka njoftuar panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues-teknik.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 05 gusht 2019, ka njoftuar panelin shqyrtues se nuk pajtohet me piken 1, 7 dhe 8 në raportin e ekspertit shqyrtues-teknik.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 14.08.2018, ku prezent kanë qenë paneli shqyrtues, përfaqësuesi i AK-së, përfaqësuesi i OE, dhe eksperti shqyrtues dhe teknik, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/ teknik, parashtresat e palëve në procedurë.

Kryetari i PSH-së gjatë seancës dëgjimore fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së ankues z. Fetoshi i cili deklaroj: "Ne qëndrojmë në tërësi prane pretendimeve tona ankimore të parashtruar në ankese dhe konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues e ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë dhe që nuk është respektuar neni 59 dhe 60 i LPP-së sepse nuk është respektuar kriteri kryesor për dhënie të kontratës që ka qenë tenderi i përgjegjshme me çmim me të ulët. Ne pajtohemi pjesërisht me mendimin e eksperteve të OSHP-së konkretisht pajtohemi në përgjigjet e dhëna në pretendimin nr 1, 5,7 dhe 8 e ku me këto konstatime edhe ekspertet e OSHP-së kanë ardhur në përfundim dhe kanë konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe nuk mund të jetë fitues i këtij tenderi. Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë ka edhe disa lëshime të tjera teknike ku nga Dosja e tij kuptohet që nuk ka ofruar përshkrimet teknike lidhur me përshkrimet prandaj edhe për këto arsyeje tjera duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm".

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-së z. Reçica i cili deklaroj: "Mendoj që Autoriteti Kontraktues i ka zbatuar ato që i ka pasur në kërkesë dhe mendoj se duhet të mbetet në fuqi vendimi i

Autoriteti Kontraktues sepse pretendimet e OE ankues siç i ka cek edhe ne shume pika edhe eksperti nuk kanë qenë kërkesa ne DT dhe njoftimin për kontratë”.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues teknik z. Spahiu deklaroi: “Ne qëndrojmë prapa raportit tone te dhënë ne ekspertize. Autoriteti Kontraktues ka kundërshtuar sqarimet për tri pretendime. Në lidhje me pretendimin ankimor 1, ku OE të rekomanduar për kontratë i mungon dokumenti për liferim tek kontratat me operator privat si dhe i mungon dëshmia e fletëpagesës për 3 projektet, për kompaninë MAX-i, për IPKO dhe për “Baruti Group”. Në njoftimin për kontratë dhe FTD, AK ka specifikuar kërkesën Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar furnizime të ngjashme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontratë në vlerë minimale prej 50.000.00€ dhe dëshminë dokumentare për këtë kërkesë. Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, nga data e publikimit te njoftimit për kontratë të dëshmuara me referenca apo procesverbale të pranimi teknik duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e referencës apo certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat.

OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar katër kontrata, dhe katër referencat apo certifikatat e përdorimit si dëshmi për të përmbushur këtë kërkesë. Megjithatë certifikata e pranimi me subjektin privat IPKO nuk kishte të specifikuar vlerën e kontratës. Një sqarim për këtë çështje AK është dashur ta bëjë gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve bazuar në RRUOPP, përkatësisht nenit 39.8. Pretendimi ankimor: OE i rekomanduar për kontratë nuk i përmbushin specifikat teknike te ofruara për kamerën modeli DH-HAC-HVF1230TLA, nuk i përmbushin kërkesat specifike minimale teknike, siç janë kërkuar nga AK ne dosje te tenderit, pasi lenti i ofruar për kamere është ofruar me i vogël se sa ai i kërkuar ne specifikacionit (kërkohet 8mm ndërsa me këtë model është 6mm). Përgjigje: Në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 për Specifikimet e detyrueshme teknike nuk ka specifikacione teknike për pajisjet harduerike. Megjithatë në formularin për çmime në formatin Excel AK ka specifikuar kërkesat teknike. Në këtë specifikim për pozicionin 1, është kërkuar ICR, OSD, 3.6mm fixed lens (6mm, 8mm optional). Në katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë specifikimi për kamerë është 3.6mm fixed lens (2.8mm, 6mm optional).

Pretendimi i fundit ankimor se kabulli i ofruar UTP (CAT 6A U-UTP installation cable), nuk e përkrash 500 MHz, sepse kabulli i ofertuar sipas katalogut mbështet deri ne 250 MHz, e jo 500 MHz siç është kërkuar, pra nuk i plotëson kërkesat minimale teknike qe janë kërkuar nga AK.

Në katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, për kabullin UTP është ofruar katalogu ku specifikohet produkti me Part Number: 7965E. Në të dhënat për këtë produkt specifikohet se ky produkt është i kategorisë 6 dhe përkrah (250MHz), e jo sikurse është specifikuar në formularin e çmimit për këtë pozicion ku është kërkuar që të jetë 500 Mhz.

Andaj, bazuar në sqarimet e mësipërme, pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: “Kërkojmë që ankesa jone të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim”

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: “Kërkojmë që ankesa e OE të hudhet poshtë dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues”.

Përfaqësuesi i OE ankues shtoj: “Konsideroj që ne nuk duhet të merremi me supozime që a do ta përmbush kontratën apo jo por duhet të fokusohemi në DT e që rezulton që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar sipas kërkesave”.

Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues shtoj: “OE i rekomanduar siç i ka vendos çmimet edhe do të furnizoj ashtu”.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, Paneli shqyrtues sqaron se pasi të gjitha pretendimet ankimore janë për çështje teknike ku për ti shqyrtuar pretendimet e OE ankues OSHP ka angazhuar ekspert shqyrtues dhe teknik të lemisë përkatëse të teknologjisë Informative ku Paneli shqyrtues konstatimet i jep konform sqarimeve të ekspertit teknik si më poshtë:

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik OE ankues se OE të rekomanduar për kontratë i mungon dokumenti për liferim tek kontratat me operator privat si dhe i mungon dëshmia e fletëpagesës për 3 projektet, për kompaninë MAX-i, për IPKO dhe për Baruti Group.

Paneli Shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit teknik të prokurimit konstaton se, në njoftimin për kontratë dhe FTD, AK ka specifikuar kërkesën *Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar furnizime të ngjashme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë minimale prej 50.000.00€.....* dhe dëshminë dokumentare për këtë kërkesë *Listën me të*

cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë të dëshmuara me referenca apo procesverbale të pranimi teknik duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pramuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e referencës apo certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat....

OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar katër kontrata, dhe katër referencat apo certifikatat e përdorimit si dëshmi për të përmbushur këtë kërkesë. Megjithatë certifikata e pranimi me subjektin privat IPKO nuk kishte të specifikuar vlerën e kontratës. Një sqarim për këtë çështje AK është dashur ta bëjë gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve bazuar në RRUOPP, përkatësisht nenit 39.8.

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik OE ankues se OE të rekomanduar për kontratë i mungon Mungon lista, e të dhënave (veprimtarive) të biznesit nga ARBK, për operatorin e rekomanduar për kontratë.

Paneli Shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit teknik të prokurimit konstaton se, Në njoftimin për kontratë, përkatësisht Përshtatshmëria profesionale, AK ka specifikuar kërkesën *Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit* dhe si dëshmi, ka kërkuar *Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje)*. OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar kopjen e certifikatës së regjistrimit, përderisa të dhënat e veprimtarisë/ve nuk janë kërkuar.

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik OE ankues se OE të rekomanduar për kontratë i mungon autorizimi i prodhuesit të zgjidhjes, deklarata e prodhuesi që zgjidhja e ofruar është funksionale dhe deklarata nga prodhuesi që zgjidhja e ofruar është zgjidhje e gatshme (turn-key solution)

Paneli Shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit teknik të prokurimit konstaton se, Në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë janë prezantuar autorizimi i kompanisë PBC për OE të rekomanduar për kontratë. Autorizimi mban datën 19 qershor 2019 dhe është dedikuar për këtë aktivitet të prokurimit. Më tej është prezantuar deklarata e kompanisë PBC përmes të cilës deklarohet se zgjidhja e propozuar është funksionale dhe përmbush të gjitha kërkesat e specifikuara në dosjen e tenderit. Gjithashtu është prezantuar edhe deklarata e kompanisë PBC përmes të cilës deklarohet se zgjidhja e propozuar është zgjidhje e gatshme.

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik OE ankues se OE të rekomanduar nuk ka ofruar Zgjidhje softwerike te mire, nuk është zgjidhje e mire pasi ne ekranin 7 inch, mund te shfaqen vetëm dy shërbime qe është vetëm si zgjidhje fiksi, ku AK nuk do te ketë mundësi te shtoj shërbime pre sistemin e pritjes, e me këtë kjo zgjidhje te ofruara nga i rekomanduari për kontratë duhet te shpallet i papërgjegjshëm, pasi qe zgjidhja nuk është funksionale dhe e qëndrueshme.

Paneli Shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit teknik te prokurimit konstaton se, Zgjidhja softwerike e ofruar nga OE, ka ofruar përmbushjen e kërkesave të përcaktuar në aneksin 1, specifikimet teknike të detyrueshme, në dosjen e tenderit dhe si e tillë përmbush kërkesat e AK, rrjedhimisht ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik OE ankues se OE të rekomanduar nuk ka asnjë dëshmi që ka implemetu një sistem te menaxhimit te radhës ne ndonjë QKMF ose AMF, për dallim qe ne si kompani kemi implementu shërbime të tilla, ku edhe janë dorëzuar dëshmitë përkatëse. Zgjedhja softwerike nuk është turn of key solution.

Paneli Shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit teknik te prokurimit konstaton se, AK nuk ka specifikuar një kërkesë të tillë në Njoftim për kontratë apo FTD, që OE duhet të ofroj dëshmi qe ka implemetuar një sistem te menaxhimit te radhës ne ndonjë QKMF ose AMF, andaj pretendimi është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik OE ankues se OE të rekomanduar për kontratë nuk i përmbushin specifikat teknike e ofruara për kamerën modeli DH-HAC-HVF1230TLA, nuk i përmbushin kërkesat specifike minimale teknike, siç janë kërkuar nga AK ne dosje te tenderit, pasi lensi i ofruar për kamere është ofruar me i vogël se sa ai i kërkuar ne specifikacion (kërkohet 8mm ndërsa me këtë model është 6mm). Po ashtu modeli i ofruar, nuk i përkrah fps (Kamera 2 MP Bullet) siç është kërkuar ne FTD (50/60fps) .

Paneli Shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit teknik te prokurimit konstaton se, Në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 për Specifikimet e detyrueshme teknike nuk ka specifikacione teknike për pajisjet harduerike. Megjithatë në formularin për çmime në formatin Excel AK ka specifikuar kërkesat teknike. Në këtë specifikim për pozicionin 1, është kërkuar ICR, OSD, 3.6mm fixed lens (6mm, 8mm optional). Në katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë specifikimi për është 3.6mm fixed lens (2.8mm, 6mm optional).

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik OE ankues se OE të rekomanduar për kontratë se Kabulli i ofruar UTP (CAT 6A U-UTP installation cable), nuk e përkrah 500 MHz, maksimale ajo e ofruar mbështet deri në 250 MHz, e jo 500 MHz siç është kërkuar, pra nuk i plotëson kërkesat minimale teknike që janë kërkuar nga AK.

Paneli Shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit teknik të prokurimit konstaton se, Në katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, për kabullin UTP është ofruar katalogu ku specifikohet produkti me Part Number: 7965E. Në të dhënat për këtë produkt specifikohet se ky produkt është i kategorisë 6 dhe përkrah (250MHz), e jo sikurse është specifikuar në formularin e çmimit për këtë pozicion ku është 500 Mhz.

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik OE ankues se OE të rekomanduar për kontratë se Nuk plotësohen kërkesat e ofruar nga OE, me ato të kërkuara nga AK tek pozicioni për "Rack Kabinet", nuk është specifikuar modeli i saktë i Rack Kabinet, ku OE ka ofruar variante të Rack Kabinet 7U (500x680x530), 9U (590x680x530), 12U (720x680x530 mm) dhe 16U (900x680x680 mm), që është në kundërshtim me FTD, pra nuk janë kërkuar variante, por zgjidhje konkrete.

Paneli Shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit teknik të prokurimit konstaton se, Në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 për Specifikimet e detyrueshme teknike nuk ka specifikacione teknike për pajisjet harduerike. Katalogu i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë ofron mundësi/variante të ndryshme, ndër to edhe modelin 7U me dimensione 600x450 mm.

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik OE ankues se OE të rekomanduar për kontratë i Mungojnë të dhëna (përshkrim) për: Inverter, Kompjuter, BNC Connector, DC jack për furnizim me rrymë, plastic channel, kabullit RG-59, kabllit, trafo-s.

Paneli Shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit teknik të prokurimit konstaton se, AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, AK nuk ka kërkuar katalog apo përshkrim të produkteve të ofruar për tenderuesit, rrjedhimisht mungesa e përshkrimit të produkteve në tender, nuk mund të shërbejë si kriter për eliminimin e OE gjatë ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - "KK Lipjan",
- 1x1 OE- "Afa ING"-Suhareke
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.